LIGJ

Nr. 73/2025

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA (KESH SHA) DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR PROJEKTIN FOTOVOLTAIK (FV) SOLAR NGA KESH-i

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për projektin fotovoltaik (FV) solar nga KESH-i, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 500, datë 19.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

(Numri i Veprimit 54350)

MARRËVESHJE GARANCIE

(Projekti Fotovoltaik (FV) Solar nga KESH)

ndërmjet

RËPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe

BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë 22 Korrik 2025

TABELA E LËNDËS

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET 1
Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde 1
Seksioni 1.02. Përkufizimet 1
Seksioni 1.03. Interpretimi 2

NENI II - GARANCIA, DETYRIMET E TJERA 2
Seksioni 2.01. Garancia 2
Seksioni 2.02. Përfundimi i Projektit 2
Seksioni 2.03. Detyrimet e tjera 2

NENI III - TË NDRYSHME 3
Seksioni 3.01. Njoftimet 3
Seksioni 3.02. Opinioni Ligjor 3

MARRËVËESHJE GARANCIE

MARRËVESHJE e datës 22 Korrik 2025 ndërmjet **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** ("Garantuesi") dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** ("Banka").

PARATHËNIE

DUKE PASUR PARASYSH SE, Garantuesi dhe Huamarrësi kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

DUKE PASUR PARASYSH SE, në bazë të një marrëveshje huaje që mban datën e kësaj Marrëveshjeje, të lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare si Huamarrës dhe Bankës ("Marrëveshja e Huasë" siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 30 milionë EURO, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Huasë, por vetëm me kusht që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë, siç parashikohet në këtë Marrëveshje; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Garantuesi, duke marrë në konsideratë lidhjen nga Banka të Marrëveshjes së Huasë me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë këto detyrime të Huamarrësit

TANI, DHE SI RRJEDHOJË, palët bien dakord si më poshtë:

NENI I – TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës, të datës 5 nëntor 2021, janë të përfshira dhe zbatohen në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin të përcaktuara plotësisht këtu, megjithatë, sipas ndryshimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë [dhe ndryshimeve të mëposhtme] (dispozita të tilla të ndryshuara në këtë mënyrë referohen në vijim si "Termat dhe Kushtet Standarde").

Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë Preambulën), përveçse kur specifikohet ndryshe ose kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen aty, termat e përcaktuar në Termat dhe Kushtet Standarde dhe Marrëveshjen e Huasë, kanë kuptimet përkatëse që u jepen aty dhe termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

"Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit"	është Ministria e Financave e Garantuesit.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një Neni ose Seksioni të specifikuar do të interpretohet, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, si një referencë ndaj atij Neni ose Seksioni të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

NENIII – GARANCIA; DETYRIMET E TJERA

Seksioni 2.01. Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si obligues kryesor dhe jo thjesht si garantues, pagesën e duhur dhe rigoroze të çdo dhe të gjitha shumave të kërkueshme në bazë të Marrëveshjes së Huasë, qoftë në maturimin e deklaruar, me përshpejtim ose ndryshe, dhe përmbushjen rigoroze të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç parashikohen në Marrëveshjen e Huasë.

Seksioni 2.02. Përfundimi i Projektit

Pa cënuar përgjithësinë e ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje ose Termave dhe Kushteve Standarde, sa herë që ka shkak të arsyeshëm dhe konstatohet se huamarrësi nuk ka fondet e mjaftueshme në dispozicion, edhe duke përfshirë përpjekjet shtesë për sigurimin e tyre, do të jenë të pamjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e vlerësuara të kërkuara për kryerjen e Projektit, Garantuesi do të ndërmarrë menjëherë masat e pajtueshme me bankën përfshirë pa kufizim, hapat e nevojshme dhe miratimet e parashikuara në kuadrin ligjorpërkatës, për t'i siguruar Huamarrësit, ose për t'i bërë Huamarrësit t'i sigurohen ato fonde që nevojiten për të përmbushur këto shpenzime dhe kërkesa.

Seksioni 2.03. Detyrimet e tjera

Garantuesi:

(a) do të sigurojë që Huamarrësi përmbush secilin prej detyrimeve të tij në bazë të Marrëveshjes së Huasë; dhe

(b) do të sigurojë që asnjë veprim, që do të pengonte ose ndërhynte në (i) ekzekutimin e Projektit ose (ii) përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit në lidhje me Projektin, nuk ndërmerret ose lejohet të merret nga Garantuesi ose ndonjë agjenci shtetërore përkatëse, ose autoritet ose ndonjë nga nënndarjet e tyre përkatëse ose ndonjë nga subjektet e zotëruara dhe të kontrolluara nga, ose që operojnë për llogari ose përfitim të ndonjërit prej tyre.

NENI III – TË NDRYSHME

Seksioni 3.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde, përveçse çdo njoftim do të konsiderohet se është dorëzuar me dorë, me postë ose në format pdf ose të ngjashëm me postë elektronike.

Për Garantuesin:

Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministria e Financave

Telefon: +35542228405
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Shërbimet e Biznesit / Veprimi Nr. 54350

Telefon: +44 20 7338 6000
E-mail: oad@ebrd.com

Seksioni 3.02. Opinioni Ligjor

Për qëllime të Seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe në përputhje me Seksionin 6.02 të Marrëveshjes së Huasë, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

NE DËSHMI TË KËSAJ, Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet të dorëohet në katër kopje në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Emri:
Titulli:

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Emri:
Titulli:

(Numri i Veprimit 54350)

MARRËVESHJE HUAJE

(Projekti Fotovoltaik (FV) Solar nga KESH)

ndërmjet

KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

dhe

BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë [____] 2025

TABELA E LËNDËS

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET
Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde
Seksioni 1.02. Përkufizimet
Seksioni 1.03. Interpretimi

NENI II - KUSHTET KRYESORE TË HUASË
Seksioni 2.01. Shuma dhe Valuta
Seksioni 2.02. Kushte të tjera Financiare të Huasë
Seksioni 2.03. Tërheqjet

NENI III - EKZEKUTIMI I PROJEKTIT .
Seksioni 3.01. Angazhime të tjera Mbështetëse të Projektit.
Seksioni 3.02. Prokurimi.
Seksioni 3.03. Angazhime të Pajtueshmërisë Mjedisore dhe Sociale
Seksioni 3.04. Konsulentët
Seksioni 3.05. Shpeshtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjes

NENI IV - ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERACIONALE .
Seksioni 4.01. Të Dhënat dhe Raportet Financiare
Seksioni 4.02. Angazhimet Negative Financiare .
Seksioni 4.03. Angazhime të tjera Financiare
Seksioni 4.04. Kryerja e Biznesit dhe Operacioneve

NENI V - PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI, ANULIMI
Seksioni 5.01. Pezullimi
Seksioni 5.02. Përshpejtimi i Maturimit.
Seksioni 5.03. Anulimi

NENI VI - HYRJA NË FUQI
Seksioni 6.01. Kushtet para Hyrjes në Fuqi
Seksioni 6.02. Opinionet Ligjore
Seksioni 6.03. Ndërprerja për Mos-hyrjen në Fuqi

NENI VII TË NDRYSHME
Seksioni 7.01. Njoftimet

SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

SKEDULI 2 – PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

SKEDULI 3- STANDARDET E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI DIELLORE

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE e datës [_____] 2025 ndërmjet **KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE** ("Huamarrësi") dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** ("Banka").

PREAMBULË

DUKE PASUR PARASYSH SE Banka është themeluar për të siguruar financim për projekte specifike për të nxitur tranzicionin ndaj ekonomive të hapura drejt tregut dhe për të promovuar iniciativën private dhe sipërmarrëse në vende të caktuara të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

DUKE PASUR PARASYSH SE Huamarrësi synon të zbatojë Projektin që përshkruhet në Skedulin 1;

DUKE PASUR PARASYSH SE Republika e Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

DUKE PASUR PARASYSH SE Banka është në proces të rregullimit të fondeve të bashkëpunimit teknik mbi bazë granti për të ndihmuar Huamarrësin në zbatimin e Projektit, në bazë të termave dhe kushteve që duhet të përcaktohen në një marrëveshje ("Marrëveshja e Grantit") ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit;

DUKE PASUR PARASYSH SE sipas një marrëveshjeje garancie të kësaj ose rreth kësaj date, ndërmjet Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës ("Marrëveshja e Garancisë" siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit nën këtë Marrëveshje; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE Banka ka rënë dakord në bazë të, *ndër të tjera*, sa më sipër për t'i dhënë një hua Huamarrësit në shumën 30 milionë EURO, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

TASHMË, SI RRJEDHOJË, me anë të kësaj palët bien dakord si më poshtë:

NENI I- TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 5 nëntor 2021, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu.

Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje (përfshirë Preambulën dhe Skedulet), përveç nëse përcaktohet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në Preambulë kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të, termat e përcaktuara në Termat dhe Kushtet Standarde kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet në vijim:

"Autorizim"	nënkupton çdo pëlqim, regjistrim, depozitim, marrëveshje, noterizim, certifikatë, licencë, miratim, leje, autorizim ose

	përjashtim nga, prej ose me ndonjë Autoritet Qeveritar, pavarësisht nëse jepet ose tërhiqet me veprim të shprehur ose konsiderohet i dhënë ose i tërhequr me mosveprim brenda ndonjë periudhe të caktuar kohore dhe të gjitha miratimet ose pëlqimet e korporatave, kreditorëve dhe aksionerëve.
"Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit"	nënkupton Administratorin e Huamarrësit.
"ClientNet"	nënkupton portalin online të Bankës për transmetimin e dokumenteve dhe informacionit ndërmjet Bankës dhe klientëve të saj dhe çdo faqe interneti zëvendësuese që Banka mund të njoftojë herë pas here Huamarrësin.
"Kërkesat e Përcaktuara të Performancës"	nënkupton Kërkesat e Performancës nga 1 deri në 8 dhe 10 (ose, siç mund të kërkohet sipas kontekstit, ndonjë prej këtyre Kërkesave të Performancës) të Kërkesave të Performancës të prillit 2019 dhe të lidhura me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës, të prillit 2019.
"Politika dhe Procedurat e Zbatimit"	nënkupton Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës, të datës 4 tetor 2017.
"Plan i Veprimit Mjedisor dhe Social"	nënkupton planin e masave zbutëse dhe përmirësimit mjedisor dhe social, një kopje e së cilit i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje si Skeduli 3, ku një plan i tillë mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, në përputhje me Seksionin 3.04 (e).
"Dokumentacion Informues për Klientin mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale"	nënkupton informacionin me shkrim të dhënë nga ose në emër të Huamarrësit për Bankën, në përputhje me raportin e kujdesit të duhur të konsulentit, të datës 24 nëntor 2023, që përmban informacion në lidhje me, ndër të tjera, çështjet mjedisore dhe sociale dhe çdo ndryshim ose plotësim të një informacioni të tillë që pranohet nga Banka.
"Ligji për Çështjet Mjedisore dhe Sociale"	nënkupton çdo ligj të zbatueshëm në çdo juridiksion përkatës, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, punëtorëve, komuniteteve ose personave të prekur nga projekti.
Çështjet Mjedisore dhe Sociale"	nënkupton çdo çështje që është objekt i ndonjë Ligji për Çështjet Mjedisore dhe Sociale, ndonjë Kërkese të Përcaktuar të Performancës ose Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social.
"Vlerësim i ndikimit në mjedis"	nënkupton vlerësimin e ndikimit të përgatitur dhe miratuar herë pas here në bazë të legjislacionit përkatës shqiptar.

"Vit Fiskal"	nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon në datën 1 janar të çdo viti.
"Autoritet Qeveritar"	nënkupton qeverinë e Garantuesit ose të çdo nënndarjeje politike të saj, qoftë shtetërore, rajonale ose vendore, dhe çdo agjenci, autoritet, degë, departament, organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore ose subjekt tjetër që ushtron kompetenca ose funksione ekzekutive, legjislative, gjyqësore, tatimore, rregullatore ose administrative ose që i përkasin qeverisë ose çdo nënndarjeje të saj (përfshirë çdo organ shumëkombësh) dhe të gjithë zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit e secilit nga sa më sipër.
"Konsulent Teknik i Pavarur"	nënkupton Tractebel Engineering GmBh ose një firmë tjetër konsulentësh që mund të zgjidhet herë pas here nga Banka për (i) përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe Projektimit Bazë dhe (ii) mbështetjen në përgatitjen e dokumentit të tenderit dhe organizimin e tenderit për Projektin.
"Projekt "	nënkupton projektin e përshkruar në Skedulin 1 që mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje të palëve.
"Dokumentet e Projektit"	nënkupton: (i) Kontratën e tipit inxhinieri, prokurim dhe ndërtim ("Kontrata EPC") ndërmjet Huamarrësit dhe kontraktorit që do të zgjidhet ("Kontraktori EPC") për përgatitjen e Projektit; (ii) marrëveshjet e Operimit dhe Mirëmbajtjes ("O&M") dhe shërbimet e operimit dhe mirëmbajtjes për Projektin, në bazë të pavarur ose si pjesë e kontratës EPC; dhe (iii) miratimin e pikës së lidhjes të Impiantit Fotovoltaik (FV) diellor të Belshit me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, nënstacioni i OST-së në Kajan.
"Statute"	nënkupton statutin, aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera përbërëse të një shoqërie.
"Detyrat e Bashkëpunimit Teknik"	nënkupton mbështetjen mbi prokurimin për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe organizimin e tenderit për projektin. Gjithashtu, projekti mori Asistencë Teknike për zbatimin e projektit prej 1.2 milionë Euro nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP), për të siguruar Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZ) dhe Inxhinierin Mbikëqyrës.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një Neni, Seksioni ose Skeduli të specifikuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij Neni ose Seksioni, ose Skeduli të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

NENI II- KUSHTET KRYESORE TË HUASË

Seksioni 2.01. Shuma dhe Valuta

Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 30 milionë EURO ("Huaja").

Seksioni 2.02. Kushte të Tjera Financiare të Huasë

(a) Shuma Minimale e Tërheqjes do të jetë 3 milionë EURO.

(b) Shuma Minimale e Parapagimit do të jetë 3 milionë EURO.

(c) Shuma Minimale e Anulimit do të jetë 3 milionë EURO.

(d) Datat e Pagesës së Interesit do të jenë 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti.

(e) (1) Huamarrësi do të shlyejë Huanë në 26 këste gjashtëmujore të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) më 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së Huasë në datën e parë të pagesës së interesit pas përvjetorit të dytë të datës së kësaj Marrëveshjeje dhe data e fundit e shlyerjes së Huasë është 10 prill 2040.

(2) Pavarësisht sa më lart, në rast se (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e Huasë para datës së parë të shlyerjes së Huasë të specifikuar në këtë Seksion 2.02. (e), dhe (ii) Banka zgjat datën e fundit të disponueshmërisë, të specifikuar në Seksionin 2.02. (f) më poshtë, në një datë që është pas Datës së parë të shlyerjes së Huasë, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të kryer në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huasë do të alokohet për shlyerje në shuma të barabarta me disa data të shlyerjes së Huasë që korrespondojnë pas datës së një tërheqjeje të tillë (ku Banka përshtat shumat e alokuara sipas nevojës, për të arritur numra të plotë në secilin rast). Banka do të njoftojë herë pas here Huamarrësin në lidhje me këto alokime.

(f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë 36 muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje ose një datë e tillë e mëvonshme që Banka, në diskrecionin e saj, mund të vendosë dhe njoftojë Huamarrësin dhe Garantuesin.

(g) Norma e Tarifës së Angazhimit do të jetë 0.5% në vit.

(h) Huaja i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

(a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e Skedulit 2, për të financuar shpenzimet e kryera (ose, nëse Banka bie dakord, që do të kryhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin.

(b) Pavarësisht Seksionit 3.05(c) të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi ka zgjedhur që komisioni fillestar të mos paguhet nga shuma e disponueshme dhe në vend të kësaj do të paguajë komisionin fillestar nga burimet e veta. Pagesa e komisionit fillestar nga Huamarrësi do të bëhet në përputhje me Seksionin 3.05(d) të Termave dhe Kushteve Standarde.

NENI III- EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Seksioni 3.01. Angazhime të tjera Mbështetëse të Projektit

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin IV të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

(a) ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për realizimin e Projektit;

(b) zbaton projektin siç përcaktohet në Skedulin 1, duke përfshirë pajtueshmëri të plotë me kërkesat dhe angazhimet shtesë të përcaktuara në Skedulin 4 (*Standardet e Zinxhirit të Furnizimit me Energji Diellore*);

(c) përdor financimin e specifikuar në Skedulin 1 ekskluzivisht për Projektin;

(d) ruan ekzistencën e saj korporative në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi;

(e) bashkëpunon me çdo konsulent të angazhuar nga BERZH-i në lidhje me, dhe mundëson zbatimin dhe përfundimin e Detyrës së Bashkëpunimit Teknik;

(f) merr, ruan, rinovon dhe është në pajtim me të gjitha liçencat, miratimet dhe regjistrimet e nevojshme;

(g) mban kontabilitetin e pranueshëm, kontrollin e kostos dhe sistemet e informacionit të menaxhimit dhe librat e kontabilitetit në përputhje me SNRF-në;

(h) zbaton të gjitha marrëveshjet në të cilat është palë ose që përbëjnë detyrim ligjor për të ose për asetet e saj;

(i) paguan të gjitha tatimet e kërkueshme (duke përfshirë, pa kufizim, taksat, tarifat ose detyrime të tjera të pagueshme në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e çdo dokumenti financiar ose dokumenti projekti) dhe paraqet në kohë deklaratat tatimore dhe raportet e qeverisë që kërkohen;

(j) ekzekuton çdo dokument tjetër dhe ndërmerr çdo veprim tjetër që Banka vendos se janë të nevojshëm për të vënë në funksion dokumentet financiare dhe dokumentet e projektit; dhe

(k) siguron që përdoret çdo disbursim për kryerjen e pagesave të synuara që përcaktohen në kontratat EPC të nënshkruara ndërmjet Huamarrësit dhe Kontraktorit EPC.

Seksioni 3.02. Prokurimi

Për qëllimet e Seksionit 4.03 të Termave dhe Kushteve Standarde, dispozitat e mëposhtme, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, si dhe shërbimet e konsulencës që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huasë:

(a) Mallrat, punët dhe shërbimet, si dhe shërbimet e konsulencës do të prokurohen nëpërmjet procedurave të hapura konkurruese;

(b) Për qëllimet e Seksionit 3.02(a), procedurat për procedurat e hapura konkurruese përcaktohen në Seksionin III të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it; dhe

(c) Të gjitha kontratat do t'i nënshtrohen procedurave të rishikimit të përcaktuara në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe do t'i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka.

Seksioni 3.03. Angazhimet e Pajtueshmërisë Mjedisore dhe Sociale

Pa kufizuar përgjithësinë e Seksioneve 4.02 (a), 4.04 (a) (iii) dhe 5.02 (c) (iii) të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

(a) Përveç kur specifikohet ndryshe në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, Huamarrësi do të kryejë dhe do të sigurojë që çdo kontraktor të kryejë projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e Projektit në përputhje me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës.

(b) Pa kufizuar sa më sipër, Huamarrësi do të zbatojë me kujdes dhe do të veprojë në përputhje me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe do të monitorojë zbatimin e këtyre planeve në përputhje me parashikimet e monitorimit të përfshira në këto plane.

(c) Huamarrësi dhe Banka mund të dakordësohen herë pas here që të ndryshojnë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social në përgjigje të ndryshimeve në rrethanat e Projektit ose Huamarrësit, rasteve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër,

(1) nëse ka ndikim negativ mjedisor ose social ose çështje që nuk ishte parashikuar ose përfshirë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, plotësisht ose sa i përket shkallës së tij,

(2) nëse ndonjë masë e zbutjes së ndikimit, të përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, nuk është e mjaftueshme për të eliminuar ose reduktuar ndonjë ndikim mjedisor ose social në nivelin e parashikuar nga Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, brenda afatit kohor të përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social; ose

(3) nëse ndonjë mospërputhje materiale me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose me ndonjë Ligj për Çështjet Mjedisore dhe Sociale është identifikuar nga Huamarrësi, Banka ose në vijim të një kontrolli të kryer nga ndonjë autoritet rregullator ose zbatimi ose nga ndonjë auditim i kryer në përputhje me Seksionin 3.04 (d);

Huamarrësi, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur dhe në bazë të miratimit të Bankës, do të zhvillojë dhe përfshijë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social masa lehtësuese shtesë ose të rishikuara që mund të jenë të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose Ligjet Mjedisore dhe Sociale, në secilin rast në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.03 Konsulentët

(a) Për të ndihmuar në zbatimin e Projektit, Huamarrësi, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Bankën, punëson ose siguron që të punësohen, siç kërkohet, dhe përdor konsulentët, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të pranueshme për Bankën, duke përfshirë konsulentët për dhënien e asistencës në zbatimin e Projektit.

(b) Huamarrësi siguron, pa pagesë, për çdo konsulent të angazhuar për dhënien e asistencës në çështjet që lidhen me Projektin ose veprimet e Huamarrësit, të gjitha lehtësitë dhe mbështetjen e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre, duke përfshirë ambientin për zyrë, pajisjet dhe furnizimet e fotokopjimit, shërbimet e sekretarisë dhe transportin, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionet e tjera që mund të jenë të rëndësishme për punën e tyre.

Seksioni 3.05 Shpeshtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjes

(a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, derisa shuma e plotë e Huasë të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raporte vjetore mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose Projektin, siç referohet në Seksionin 5.02 (c) (iii) të Termave dhe Kushteve Standarde, brenda 60 ditëve pas përfundimit të periudhës vjetore për të cilën raportohet. Këto raporte përfshijnë informacione për çështjet e mëposhtme specifike:

(1) informacion mbi pajtueshmërinë nga Huamarrësi me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, siç përshkruhet në Seksionin 3.04 (a) dhe zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social;

(2) informacion mbi zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesit dhe mekanizmin e ankesave, të kërkuara nga Kërkesa e Përcaktuar e Performancës 10, duke përfshirë një përmbledhje të ankesave të marra dhe mënyrën e zgjidhjes së këtyre ankesave;

(3) informacion mbi pajtueshmërinë nga Huamarrësi me Ligjet Mjedisore dhe Sociale në lidhje me Projektin, duke përfshirë një përshkrim të çdo pretendimi, procedimi, urdhri ose hetimi të filluar ose rrezikuar ndaj Huamarrësit, statusin e çdo Autorizimi të nevojshëm për Projektin, rezultatet e çdo inspektimi të kryer nga ndonjë autoritet rregullator, çdo shkelje të ligjeve, rregulloreve ose standardeve në fuqi dhe çdo veprim korrigjues ose gjobë në lidhje me një shkelje të tillë, një përmbledhje të çdo njoftimi, raporti dhe komunikimi tjetër material mbi çështjet mjedisore dhe sociale në lidhje me Projektin, të paraqitura nga Huamarrësi çdo autoriteti rregullator dhe çdo rrethanë tjetër që i shkakton përgjegjësi Huamarrësit për ndonjë çështje mjedisore dhe sociale;

(4) informacion mbi menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të dhënat mbi shëndetin dhe sigurinë në punë të Projektit, duke përfshirë shkallën e aksidenteve, incidentet me kohën e humbur në punë dhe lëndimet e mundshme, çdo masë parandaluese ose lehtësuese të marrë ose të planifikuar nga Huamarrësi, çdo trajnim të personelit për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe çdo nismë tjetër në lidhje me menaxhimin e sigurisë dhe shëndetin në punë, të cilat janë zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

(5) një përmbledhje të çdo ndryshimi në Ligjet Mjedisore dhe Sociale që mund të kenë efekt material në Projekt; dhe

(6) kopje të çdo informacioni mbi çështjet mjedisore dhe sociale të paraqitura periodikisht nga Huamarrësi aksionerëve të tij ose publikut të gjerë; dhe

(b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të dorëzojë raportet periodike të Projektit të përmendura në Seksionin 4.04(a)(v) të Termave dhe Kushteve Standarde çdo tremujor, brenda 60 ditëve pas përfundimit të periudhës që raportohet, derisa Projekti të ketë përfunduar. Këto raporte duhet të përfshijnë elementet e mëposhtëm specifikë:

(1) Informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

(A) progresin fizik të përmbushur në zbatimin e Projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

(B) vështirësitë ose vonesat aktuale ose të pritshme në zbatimin e Projektit dhe efektin e tyre në planin e zbatimit, dhe hapat aktualë të ndërmarrë ose të planifikuar për të kaluar vështirësitë dhe shmangur vonesat;

(C) ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të Projektit;

(D) ndryshimet kyçe të punonjësve në personel, konsulentëve ose kontraktorëve;

(E) çështjet që mund të ndikojnë në koston e Projektit;

(F) përditësimin mbi statusin e zbatimit të Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social; dhe

(G) çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të çdo pjese të Projektit.

(2) Pasqyrat financiare që tregojnë detajet e shpenzimeve të kryera sipas secilës pjesë të Projektit dhe Tërheqjet, së bashku me një pasqyrë që tregon:

(A) vlerësimet origjinale të kostove;

(B) vlerësimet e rishikuara të kostove, nëse ka, me arsyet për ndryshime;

(C) shpenzimet fillestare të vlerësuara dhe shpenzimet aktuale të deritanishme;

(D) arsyet për ndryshimet e shpenzimeve aktuale deri tani nga shpenzimet fillestare të vlerësuara deri tani; dhe

(E) shpenzimet e vlerësuara për tremujorët e mbetur të vitit.]

(c) Sapo të vihet në dijeni për ndodhinë e ndonjë incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin ose Projektin, që ka ose mund të ketë një efekt të dukshëm negativ tek mjedisi, punëtorët, ose për publikun ose shëndetin dhe sigurinë në punë, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë pas kësaj do t'i japë njoftim Bankës, duke specifikuar natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar atë. Kur një incident përfshin informacion sensitiv në lidhje me një person ose ndonjë rrezik për hakmarrje, njoftimi fillestar për Bankën nuk do të përfshijë asnjë detaj të identitetit të personave të përfshirë. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër:

(1) një incident ose aksident lidhet me Projektin, nëse ndodh në ndonjë vend të përdorur për Projektin ose nëse është shkaktuar nga punëtorët e Projektit dhe/ose objektet, pajisjet, automjetet ose mjetet lundruese të përdorura për ose që kanë lidhje me Projektin (pavarësisht nëse përdoren ose jo në ndonjë vend të Projektit dhe pavarësisht nëse përdoren ose jo nga persona të autorizuar ose të paautorizuar);

(2) një incident ose aksident konsiderohet të ketë efekt të dukshëm negativ për mjedisin, ose për publikun ose shëndetin ose sigurinë në punë, nëse:

(A) sipas ndonjë ligji të zbatueshëm, kërkohet dërgimi i njoftimit për një incident ose aksident të tillë tek çdo Autoritet Qeveritar,

(B) një incident ose aksident i tillë përfshin aksident me vdekje të ndonjë personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar nga Huamarrësi),

(C) më shumë se një person (pavarësisht nëse këto persona janë ose jo të punësuar nga Huamarrësi) ka marrë dëmtime të rënda dhe shtrimi në spital është i domosdoshëm;

(D) një incident i tillë përfshin dhunë dhe ngacmim, bullizëm, frikësim dhe/ose shfrytëzim, duke përfshirë çdo formë të dhunës me bazë gjinore;

(E) një incident i tillë përfshin punë të detyruar dhe të fëmijëve, në lidhje me Projektin; ose

(F) publiku është vënë ose mund të vihet në dijeni mbi një incident ose aksident të tillë, qoftë përmes mbulimit nga media ose ndryshe.

(c) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo kundërshtim ose peticion të rëndësishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut, në drejtim të, ose lidhur me Huamarrësin ose Projektin, që mund të ketë një efekt negativ material tek Huamarrësi ose Projekti ose që është bërë ose mund të bëhet publike përmes mbulimit në media ose ndryshe. Brenda dhjetë ditëve pas çdo njoftimi të tillë, Huamarrësi do të paraqesë një raport të pranueshëm për Bankën, që specifikon rezultatin e hetimit të Huamarrësit për një kundërshtim të tillë, dhe çdo hap të ndërmarrë ose që propozohet të ndërmerret nga Huamarrësi, për të zgjidhur çështjet e ngritura në kundërshtimin.

NENI IV- ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERACIONALE

Seksioni 4.01. Të Dhënat dhe Raportet Financiare

(a) Huamarrësi do të mbajë procedurat, të dhënat dhe llogaritë siç duhet, për të pasqyruar, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuara ndërkombëtarisht, të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme, veprimet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe Filialeve të tij, nëse ka, dhe të përshtatshme, për të monitoruar dhe regjistruar progresin e Projektit (përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të rrjedhin prej tij).

(b) Huamarrësi:

(1) do të ketë të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat e tij financiare (përfshirë bilancin, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në pozicionin financiar dhe shënimet mbi to), dhe të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të Ndërmarrjeve të tij, për çdo Vit Fiskal, të audituar nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht;

(2) do t'i japë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 180 ditë pas përfundimit të çdo viti fiskal:

(A) kopje të vërtetuara të pasqyrave të tij financiare për një Vit të tillë Fiskal, siç janë audituar;

(B) raportin e një kontrolli të tillë nga auditues të tillë me një objekt të tillë dhe në detaje të tilla siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme; dhe

(C) një pasqyrë të të gjitha transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe secilit nga Ndërmarrjet dhe Filialet e tij;

(3) do t'i paraqesë Bankës informacione të tjera në lidhje me këto të dhëna, llogari dhe pasqyra financiare, dhe auditimin e tyre, siç mund të kërkojë Banka herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

(c) Nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje derisa shuma e plotë e Huasë të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës:

(1) Çdo tremujor, brenda 60 ditëve pas përfundimit të tij, pasqyrat financiare të pa-audituara në SNRF, një diskutim mbi menaxhimin dhe analizën e pasqyrave financiare;

(2) Një muaj para përfundimit të çdo viti financiar, një projekt-plan buxhetor 3-vjeçar në nivel Huamarrësi, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, Plan i cili do të përfshijë, por pa u kufizuar tek shpenzimet operative, produktin dhe tarifat e planifikuara, investimet e të ardhurave dhe ndikimin e mundshëm në raportet financiare;

(3) Njoftim të menjëhershëm për çdo ndryshim të propozuar në objektin, projektimin ose funksionimin e Projektit ose biznesit ose operacioneve të Huamarrësit; dhe

(4) Huamarrësi do t'i sigurojë BERZH-it, në çdo rast në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, sapo të jenë të disponueshme, por në çdo rast brenda 10 (dhjetë) ditësh pune pas përfundimit të çdo tremujori deri në datën e përfundimit të Projektit, një raport të progresit të ndërtimit të përgatitur nga Inxhinieri i Mbikëqyrjes, i cili paraqet në detaje progresin e ndërtimit të Projektit, duke përfshirë çdo papajtueshmëri në lidhje me progresin e ndërtimit kundrejt objektivave të kërkuara për tu përmbushur që specifikohen në planin e përcaktuar në Raportin e Planifikimit të Projektit dhe progresin e zbatimit të Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social në formën e përcaktuar në Skedulin 3 (Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social).

Seksioni 4.02. Angazhimet Negative Financiare

(a) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

(1)të hyjë në ndonjë marrëveshje ose angazhim për të garantuar, ose në ndonjë mënyrë ose sipas ndonjë kushti për tu bërë i detyruar për të gjithë ose ndonjë pjesë të një detyrimi financiar ose tjetër të një personi tjetër, përfshirë çdo Ndërmarrje ose Filial;

(2)të hyjë në ndonjë transaksion me ndonjë person, përveç në rrjedhën e zakonshme të biznesit, mbi kushte të zakonshme tregtare dhe në bazë të angazhimeve të tregut, ose të krijojë ndonjë agjenci të vetme dhe ekskluzive të blerjeve ose shitjeve, ose të hyjë në ndonjë transaksion përmes të cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë sesa çmimi i zakonshëm tregtar për çdo blerje ose mund të marrë më pak sesa çmimi i plotë i tregut (sipas zbritjeve normale të tregut) për produktet ose shërbimet e tij;

(3)të hyjë në ndonjë partneritet, ndarje fitimi ose marrëveshje për tarifat e liçencave ose marrëveshje tjetër të ngjashme me të cilën të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit ndahen ose mund të ndahen me ndonjë person tjetër;

(4)(në mënyrë vullnetare ose jo-vullnetare) të kryejë ndonjë parapagim, riblerje ose shlyerje të parakohshme të ndonjë borxhi ose të bëjë shlyerje të ndonjë borxhi në përputhje me ndonjë dispozitë të një marrëveshjeje ose note që siguron drejtpërdrejt ose tërthorazi përshpejtimin e shlyerjes në kohë ose shumë financiare, përveç nëse në ndonjë rast të tillë, nëse Banka e kërkon, Huamarrësi në të njëjtën kohë kryen një parapagim proporcional të shumës principal të papaguar të Huasë në përputhje me dispozitat e Seksionit 3.07 të Termave dhe Kushteve Standarde (përveç kur shuma e ndonjë parapagimi të tillë nuk do t'i nënshtrohet kërkesave të shumës minimale të parapagimit);

(5) të shesë, transferojë, japë me qira ose ndryshe disponojë të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të aseteve të tij (në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh, të lidhura ose ndryshe);

(6)të ndërmarrë ose lejojë ndonjë bashkim, konsolidim ose riorganizim;

(7) të marrë përsipër çdo borxh të ri financiar, duke përjashtuar huatë nga Ministria e Financave, nëse një borxh i tillë do të rezultonte në shkelje të Seksionit 4.03, pa pëlqimin paraprak të BERZH-it.

(b) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse informon Bankën të paktën 30 ditë para, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin që mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

(1) të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose angazhim të ngjashëm me të cilën biznesi ose veprimet e tij menaxhohen nga ndonjë person tjetër, duke përfshirë çdo ndërmarrje ose filial; ose

(2) të formojë ndonjë Ndërmarrje ose të marrë masa ose lejojë të ekzistojnë hua ose paradhënie, ose depozita (përveç depozitave në rrjedhën e zakonshme të biznesit në banka të njohura) me persona të tjerë ose investime në ndonjë person, përfshirë çdo Ndërmarrje ose Filial; megjithatë, me kusht që Huamarrësi do të jetë i lirë të investojë në letra me vlerë të tregtueshme të shkallës së investimeve afatshkurtra, vetëm për t'i dhënë punësim të përkohshëm burimeve pasive të Huamarrësit.

Seksioni 4.03. Angazhime të tjera Financiare

Pa kufizuar përgjithësinë e Seksionit 4.02, Huamarrësi do të mbajë një raport të borxhit neto ndaj EBITDA-s prej jo më shumë se 5.5x në 2025 dhe 2026, dhe 4.5x për pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së Huasë (**"Raportet financiare"**).

Raportet Financiare do të llogariten bazuar në pasqyrat financiare të audituara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Për qëllim të seksionit 4.03, "Borxhi neto" do të përfshijë të gjithë borxhin financiar (afatgjatë dhe afatshkurtër), duke përjashtuar: i) borxhin e trashëguar që i përket OST-së dhe OSHEE-së që mbartet në bilancin e Huamarrësit, pavarësisht se OST-ja dhe OSHEE-ja janë debitorët dhe ii) çdo borxh të dhënë nga Ministria e Financave e Shqipërisë si mbështetje buxhetore, minus paratë kesh dhe "EBITDA" do të përfshijë fitimet para interesit, zhvlerësimit dhe amortizimit (duke përjashtuar shpenzimet e jashtëzakonshme jo-operative).

Seksioni 4.04. Kryerja e Biznesit dhe Operacioneve

Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

(a) kryen biznesin dhe veprimet e tij në përputhje me standardet dhe praktikat administrative, financiare, inxhinierike dhe të qëndrueshme të njohura ndërkombëtarisht, dhe duke marrë parasysh të gjitha politikat kryesore të funksionimit;

(b) ndërmerr menjëherë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, për të vazhduar veprimet e tij dhe për të marrë, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, kompetencat, privilegjet dhe ekskluzivitetet që janë të nevojshme për ushtrimin e biznesit të tij, duke përfshirë realizimin e Projektit;

(c) nuk shet, jep me qira ose disponon ndryshe ndonjë prej aseteve të tij që kërkohen për kryerjen efikase të veprimeve të tij ose disponimi i të cilave mund të dëmtojë aftësinë e tij për të përmbushur në mënyrë të pranueshme cilindo nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

(d) njofton menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar ndonjë dispozitë të Statutit dhe i jep Bankës një mundësi të përshtatshme për të komentuar mbi këtë propozim, përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me të;

(e) merr dhe mirëmban me siguruesit përgjegjës, ose merr masa të tjera të pranueshme për Bankën në lidhje me sigurimin ndaj rreziqeve të tilla të humbjes, dëmtimit dhe përgjegjësisë dhe në shuma të tilla që janë në përputhje me praktikën e duhur; dhe

(f) në çdo kohë operon dhe mirëmban impiantin, objektet, pajisjet dhe pasurinë e tij në gjendje të mirë pune dhe kryen të gjitha riparimet dhe rinovimet e nevojshme, sa më shpejt që të jetë e nevojshme, të gjitha në përputhje me biznesin e qëndrueshëm dhe praktikën financiare;

NENI V- PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI; ANULIMI

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e Seksionit 7.01 (a) (xvii) të Termave dhe Kushteve Standarde:

(a) Kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e energjisë në territorin e Garantuesit do të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë në një mënyrë ndryshe nga sa miratohet nga Banka me shkrim;

(b) Statuti do të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë;

(c) Huamarrësi do të ketë ndërmarrë ndonjë nga veprimet e përmendura në Seksionin 4.02 (b), në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe negativisht në veprimet ose gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të kryer Projektin ose përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

(d) Kontrolli i Huamarrësit do t'i jetë transferuar një pale tjetër përveç Garantuesit.

Seksioni 5.02. Përshpejtimi i Maturimit

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e Seksionit 7.06 (f) të Termave dhe Kushteve Standarde:

(a) Huamarrësi nuk respekton asnjë marrëveshje pozitive të parashikuar në Seksionin 3.2 ose marrëveshjen negative të parashikuar në Seksionin 3.3 të Skedulit 4 (*Standardet e Zinxhirit të Furnizimit me Energji Diellore*).

(b) Ndodh një kërkesë për punë të detyruar.

Seksioni 5.02. Anulimi

Nëse në çdo moment Banka vendos se një pagesë nga, ose përdorim i Llogarisë së Posaçme është bërë në kundërshtim me kërkesat e Skedulit 3 dhe përcakton shumën e Huasë për të cilën zbatohet një keqpërdorim i tillë, Banka, me njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje në lidhje me këtë shumë. Me dhënien e një njoftimi të tillë, kjo shumë e Huasë do të anulohet.

NENI VI- HYRJA NË FUQI

Seksioni 6.01. Kushtet para Hyrjes në Fuqi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e Seksionit 9.02 (c) të Termave dhe Kushteve Standarde, si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë:

(a) Origjinalet e ekzekutuara të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Garancisë dhe opinioneve ligjore të përmendura në seksionin 6.02.;

(b) Kopje të vërtetuara të Dokumenteve të Projektit, të ekzekutuara në rastin e dokumenteve të renditura në pjesët (i) dhe (ii) të përkufizimit në Seksionin 1.02;

(c) Kopje të vërtetuar të miratimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

(d) Kopje të vërtetuar të miratimit nga OST-ja për lidhjen e impiantit diellor në rrjetin e transmetimit;

(e) Një raport sigurimi nga këshilltari i sigurimeve të Bankës që tregon se të gjitha politikat dhe miratimet e kërkuara janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe kopje të vërtetuara të këtyre politikave dhe miratimeve të sigurimit.

(f) Kopje të vërtetuar të lejes së ndërtimit nga autoritetet e planifikimit (specifikisht Këshilli Kombëtar i Territorit);

(g) Kopje të vërtetuar të Lejes Përfundimtare për zhvillimin e projektit, të dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Këshilli i Ministrave;

(h) Dokumentet që konfirmojnë ekzekutimin e kontratës EPC pas përfundimit të procesit të prokurimit.

(j) Në lidhje me çështjet e Zinxhirit të Furnizimit të përcaktuara në Skedulin 4 (*Standardet e Zinxhirit të Furnizimit me Energji Diellore*): (i) ofrimi i një Sistemi të duhur të Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit, i pranueshëm për BERZH-in; (ii) dëshmi të pranueshme për BERZH-in se Sistemi i Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit është zbatuar nga Huamarrësi; (iii) dorëzimi i një Harte të Zinxhirit të Furnizimit që konfirmon se zinxhiri i furnizimit të Produkteve të Energjisë Diellore është siç paraqitet në draft hartën e zinxhirit të furnizimit që mund të pranohet nga BERZH-i në ose para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe (iv) një kopje të Marrëveshjes së Furnizimit të Modulit, të pranueshme për BERZH-in.

Seksioni 6.02. Opinionet Ligjore

(a) Për qëllime të Seksionit 9.03 (a) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Drejtuesi i Departamentit Ligjor.

(b) Për qëllime të Seksionit 9.03 (b) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03. Ndërprerja për Mos-hyrjen në Fuqi

Data 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje specifikohet për qëllimet e Seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standarde.

NENI VII- TË NDRYSHME

Seksioni 7.01. Njoftimet

(a) Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllime të Seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde, përveç që çdo njoftim do të konsiderohet se dorëzohet dorazi, me postë ose në format "pdf" ose format të ngjashëm me postë elektronike:

Për Huamarrësin:

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE
Blloku "Vasil Shanto"
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

Telefon: [_____]
Email: [_____]

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
5 Bank Street
London E14 4BG
United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Departamentit të Shërbimeve Bankare/Veprimit Nr. 54350
E-mail: bankingservices@ebrd.com

(b) Banka mund të ftojë Huamarrësin që të regjistrohet për të përdorur ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik dhe, nëse Huamarrësi dhe Banka bien dakord të përdorin ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër nga Huamarrësi për Bankën ose nga Banka për Huamarrësin (përveç ndonjë njoftimi, aplikimi ose komunikimi tjetër që kërkohet nga kjo Marrëveshje [ose Marrëveshje tjetër Financiare], të jetë në një kopje origjinale, e vërtetuar ose në letër), sipas termave dhe kushteve të ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, mund të jepet ose bëhet duke postuar këtë njoftim, aplikim ose komunikim tjetër në ClientNet ose të dërgohet në përputhje me kushtet e rëna dakord në lidhje me atë formë tjetër të komunikimit elektronik.

(c) Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër të dorëzuar dorazi, me postë ose faks ose përmes ClientNet ose një forme tjetër të komunikimit elektronik të rënë dakord ,do të jetë efektiv vetëm kur merret (ose bëhet i disponueshëm) në formë të lexueshme, me kusht që çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që merret (ose bëhet e disponueshme) pas orës 5:00 pasdite, në vendin ku pala së cilës i është dërguar njoftimi, aplikimi ose komunikimi përkatës, ka adresën e saj për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se bëhet efektiv në ditën vijuese.]

(d) Më poshtë janë emrat, titujt dhe adresat e postës elektronike të personave të caktuar si kontaktet fillestare të Huamarrësit për qëllimet e çdo ftese që Banka mund t'i dërgojë Huamarrësit në lidhje me ClientNet.

Emri	***Funksioni***	***Adresa e e-mailit***	***Gjuha - Anglisht***

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje dhe të dorëzohet në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

Nga:_____
Emri:
Funksioni:


BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:_____
Emri:
Funksioni:

SKEDULI 1- PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Projekti konsiston në projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e një impianti me energji diellore 50.274 MWp të montuar në tokë, i vendosur në rajonin e Belshit. Përshkrimi i projektit bazohet në studimin e fizibilitetit dhe mund të pësojë ndryshime të mëtejshme të dakordësuara ndërmjet palëve.

Zona e përzgjedhur është në Belsh, në veri të rezervuarit të Thanës, me një sipërfaqe të përgjithshme parcelash të disponueshme rreth 68.5 hektarë që fillimisht është e mjaftueshme për vendosjen e kapacitetit të synuar të energjisë prej 50 MWp. Zona në vetvete është sfiduese dhe ndodhet në një terren kodrinor, si rrjedhojë duhet të kryhen punime civile shtesë për nivelimin e vendpunimit, që të konsiderohet e përshtatshme për vendosjen e modulit FV, i cili është marrë parasysh për vlerësimin CAPEX të Projektit. Gjithashtu, është e domosdoshme që rrugët të përmirësohen që të sigurohet se janë të përshtatshme për transportin e pajisjeve dhe fillimin e punimeve në kantier/vendpunim.





Modulet FV: Duke pasur parasysh kufizimet në kantier/vendpunim, impianti do të ndërtohet duke përdorur dopjo xham bifacial me pjerrësi fikse të cilësisë më të mirë, module silikoni monokristalor me efikasitet të lartë. I gjithë projekti paraprak i impiantit parashikon në total 75600 module silikoni monokristaline FV që përdoren zakonisht në instalimet FV të shkallës së mesme. Efikasiteti i moduleve supozohet në kapacitetin 21.4%, me fuqinë/kapacitetin e markës së emrit prej 665 Wp.

Invertitorët: Bazuar në hulumtimin në treg dhe praktikën e zakonshme, Konsulenti Teknik i Pavarur ka rekomanduar që të merren invertitorë të vargut të montuar pranë rreshtave të vargjeve FV, të lidhur vetë me nënstacionin LV/TM nëpërmjet kanalizimit të kabllove me rrymë alternative (AC) të tensionit të ulët.

Strukturat e montimit të modulit FV: Duke marrë parasysh zonën e kufizuar të shfrytëzueshme të disponueshme, u konsiderua një sistem me pjerrësi fikse 20°, me pamje nga jugu me azimut 0°, për të kufizuar hapjen e nevojshme të rreshtave për shkak të hijes pranë dhe për të optimizuar përdorimin e tokës dhe përfituar rendimentin. Detajet e ndërtimit duhet të analizohen në fazën bazë të projektimit, megjithatë, rekomandohet të merren në konsideratë shumëfishat e 30 për madhësinë e vargut dhe projektimin e skicimit. Sipas skicimit, supozohen tabela me 2 module në konfigurim portret me 15 module në gjatësi (tabelë e shkurtër fleksibël) dhe me 30 module në gjatësi.

Struktura me kënd fiks është mënyra më e thjeshtë e montimit të një moduli FV. Ndërsa sistemet Tracker (gjurmues) premtojnë fitime më të larta të rendimentit, ato kërkojnë gjithashtu nivele më të mëdhenj të rreshtave për shkak të hijeve më të gjata që lëshohen prej tyre. Kjo i bën ato më të përshtatshëm për zona me sasi të mëdha toke të përshtatshme për instalimin e FV-së, ndërsa sistemet fikse janë më ekonomike për vendet me sipërfaqe toke të kufizuar të shfrytëzueshme dhe terren të vështirë. Gjurmuesit u konsideruan si pjesë e vlerësimit të Konsulentit Teknik të Pavarur dhe u konsideruan të papërshtatshëm për kantierin/vendpunimin e Projektit.

Lidhja me Rrjetin Elektrik: Zona e zgjedhur ndodhet rreth 9 km larg nënstacionit më të afërt në Kajan, i identifikuar si pika e parashikuar e lidhjes me rrjetin. Konsulenti Teknik i Pavarur realizoi një studim të plotë të ndërlidhjes së rrjetit dhe arriti në përfundimin se infrastruktura aktuale e rrjetit është mjaft e fortë për të vendosur impiantin FV të Belshit, pa pasur nevojë për përforcime të menjëhershme dhe të zgjatura të rrjetit. Rrjeti tregoi elasticitet dhe qëndrueshmëri jo vetëm në operacionet rutinë, por edhe nën skenarët e gabimeve të rasteve N-1 dhe N-2. Megjithatë, sa më poshtë kërkohen dhe llogariten për projektin:

- **Linja e re mbitokësore (OHL) 110 kV** - Për të lehtësuar lidhjen e Impiantit FV të Belshit me nënstacionin ekzistues është planifikuar të ndërtohet një linjë e re mbitokësore 110 kV. Dizajni/projektimi konceptual dhe rruga e linjës mbitokësore dhe pengesat përreth jepen në skicat e siguruara nga Konsulenti Teknik i Pavarur, si pjesë të projektimit bazë. Aty ku, sipas PVMS-së, shmanget pylli në veri-lindje të vendndodhjes së vendpunimit.
- **Nënstacioni i ri i Belshit 20 kV/110 kV** - Impianti FV ofron hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një nënstacioni të ri 20 kV/ 110 kV, i cili do të vendoset në verilindje të impiantit. Tensioni rritet nga 20 kV në 110 kV nëpërmjet një transformatori të fuqisë 63 MVA dhe më pas hyn në linjën e re OHL përmes një sfere dalëse, duke përfshirë komutuesin HV. Nënstacioni përfshin godinën e kontrollit, duke përfshirë transformatorin ndihmës, sallën e kontrollit, kuzhinën dhe sallën e kabinës së MV-së dhe komutuesit. Gjithashtu, nënstacioni siguron hapësirë të mjaftueshme për parkim si për personelin e punës, ashtu edhe për vizitorët.
- **Zgjerimi i nënstacionit ekzistues në Kajan** - Nënstacioni ekzistues në Kajan do t'i nënshtrohet punimeve të zgjerimit siç tregohet në skicën E-08 të projektit bazë. Përafërsisht 300 metra katrorë shtesë do të përdoren për të zgjeruar oborrin dhe për të lehtësuar ndërtimin e gjirit të ri dhe komutuesit të HV-së për të vendosur lidhjen nga nënstacioni i ri në Belsh.

CAPEX: CAPEX është vlerësuar bazuar në burime të besueshme publike dhe është ndryshuar sipas përvojave të mëparshme të projektit të konsulentit. Baza e vlerësimeve është raporti IRENA i gushtit 2023, "Kostot e Prodhimit të Energjisë 2022". Capex përfshin kostot EPC, duke përfshirë modulet dhe pajisjet e invertitorit, punimet inxhinierike elektrike, punimet civile, lidhjet në rrjet, financimin, projektimin dhe kostot e personelit.

Komponenti i Kostove	**Kostoja [EURO/kW]**
Modulet	293.70
Invertitorët	43.10
Vendosja e mbështetësve dhe montimi	75.70
Lidhja me rrjetin	82.30
Kabllo / instalime elektrike	44.90
Siguria dhe mbrojtja	16.40
Monitorimi dhe kontrolli	6.60
Instalimet mekanike	60.10
Instalimet elektrike	46.80
Punimet civile	26.00
Inspektimi	15.00
Rezerva	75.40
Dizjani/projektimi i sistemit	19.00
EURO/kW	**805.00**

EPC dhe O&M: Kontraktori EPC dhe O&M do të caktohet në vijim të një tenderi ndërkombëtar për punimet e projektimit-ndërtimit-operimit të infrastrukturës FV dhe punimeve të lidhjes në rrjet, si dhe programit të mirëmbajtjes. Ofertuesit do të bëjnë ofertë sipas specifikimit teknik që është përgatitur tashmë nga Konsulenti i Mbështetjes së Prokurimit të caktuar nga Banka. Tenderi do të ndjekë PP&R të Bankës. Dokumentet e tenderit do të përgatiten me mbështetjen e TC-së të financuar nga donatorët nga një konsulent prokurimi i caktuar nga Banka.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat mund të pësojnë ndryshime të tilla për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: **Investimi kapital**

Të ardhurat e huasë do të përdoren për financimin e investimeve kapitale në lidhje me zhvillimin, ndërtimin dhe funksionimin e Projektit që do të zbatohet sipas një Kontrate EPC me çelësa në dorë (projektimi, ndërtimi dhe funksionimi). Projekti mori një grant investimi prej 8.05 milionë Euro nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP) për financimin e punimeve, mallrave dhe shërbimeve që lidhen me zbatimin e Projektit.

Pjesa B: **Bashkëpunimi Teknik**

(a) Mbështetje me konsulencë për Huamarrësin për realizimin e procesit të prokurimit dhe dokumentacionin e tenderit për prokurimin e punimeve.

(b) Mbështetje me konsulencë për zbatimin e projektit, e financuar nga KIBP-ja për dhënien e mbështetjes për klientin për zbatimin e projektit, si dhe mbikëqyrjen e kontratës së punimeve.

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e llogaritur e kontratës	Financimi nga BERZH-i	Financimi nga të tjerë	
				Financieri	Shuma
[1]	[2]	[3]	[4]	[5]	[6]
	Pjesa A- Investimi kapital				
1	Projektimi, ndërtimi dhe funksionimi për fotovoltaik 50 MV	**40,471,000**	30,000,000	KIBP	8,050,000
				KESH	2,421,000
	Nën-totali Capex	**40,471,000**	**30,000,000**		**10,471,000**
	Pjesa B- Bashkëpunimi Teknik				
2	Inxhinieri i Mbikëqyrjes	**800,000**		KIBP	800,000
3	Konsulenti i Mbështetjes së NJZP-së	**400,000**		KIBP	400,000
	Nën-totali TC	**1,200,000**			1,200,000
	TOTALI	**41,671,000**	**30,000,000**		**11,671,000**

3. Projekti parashikohet të përfundojë deri më 30 shtator 2028.

SKEDULI 2 – PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Shkurtimet dhe përkufizimet:

BERZH: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

M&S: Mjedisore & Sociale

VNM: Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (siç përcaktohet nga legjislacioni shqiptar)

EPC-PMMS: Plani i Menaxhimit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit

SMMS: Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

KP: Kërkesat e Performancës (siç përcaktohet nga Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it, 2019)

Projektit: Projekti është aktiviteti i biznesit i përcaktuar në marrëveshjen e financimit për projektin ferma fotovoltaike (FV) diellore lundruese nga KESH

PAPI: Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit

Nr.	Veprimi	Rreziqet mjedisore dhe sociale	Kërkesa (Ligjore, BERZH KP, IPGJ)	Burimet, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm
PR1	**Vlerësimi dhe Menaxhimi i Ndikimeve dhe Çështjeve Mjedisore dhe Sociale**					
1.1	**Menaxheri PVMS:** KESH të caktojë një Menaxher M&S për Projektin. Menaxheri M&S do të jetë përgjegjës për zbatimin e PVMS-së në kohë dhe në mënyrë të efektshme, si dhe për garantimin e pajtueshmërisë së ndërtimit dhe	Zbatimi i kërkesave për Çështjet Mjedisore & Sociale	Legjislacioni kombëtar BERZH KP1	KESH	Para nënshkrimit të huasë	Përgjegjësia i caktohet një personi të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. BERZH-it i jepet emri dhe kontakti i personit përgjegjës.

	funksionimit të Projektit me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat M&S të BERZH-it.					
1.2	**SMMS I KESH:** KESH-i të sigurojë një plan kohor të përditësuar për përgatitjen e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të integruar në nivel korporate (ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001). KESH të integrojë impiantet FV në objektin e këtij SMMS-je.	Zbatimi i kërkesave për Çështjet Mjedisore & Sociale	BERZH KP1 PVMS e Korporatës së KESH-it	KESH	Para nënshkrimit të huasë Çdo vit	BERZH-i njoftohet për afatin kohor të përditësuar Raportohet pranë BERZH-it mbi progresin e zbatimit
1.3	**Lejet dhe autorizimet:** Të merren dhe ruhen të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme mjedisore, sociale dhe të shëndetit & të sigurisë që kërkohen për Projektin. Të mbahet një regjistër posaçërisht për këto leje dhe autorizime, duke treguar qëllimin dhe datën e vlefshmërisë së tyre, nëse ka.	Pajtueshmëria me kërkesat rregullatore	Legjislacioni kombëtar	Mbajtësi i PVMS-së së KESH	Siç kërkohet nga rregulloret kombëtare, megjithatë, miratimi i VNM-së duhet të jepet përpara disbursimit të parë	Lejet dhe autorizimet merren dhe ruhen. BERZH-it i jepet regjistri, nëse e kërkon
1.4	**Menaxheri i SHSM-së:** Të kërkohet që EPC-ja të rekrutojë një "Menaxher SHSM" me përvojë, përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e të gjitha detyrimeve të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit të Kontraktorit EPC dhe zinxhirit të tij të nënkontraktorëve, sipas Kontratës EPC, PVMS-së, VNM-së së miratuar dhe legjislacionit shqiptar për çështjet	Zbatimi i kërkesave për Çështjet Mjedisore & Sociale	Legjislacioni kombëtar BERZH KP1	KESH	Tre muaj para mobilizimit të EPC-së në kantier.	Përgjegjësia i caktohet një personi të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme dhe vazhdon gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës EPC. KESH-i dhe BERZH-i njoftohen për emrin kontaktin e personit përgjegjës.

	mjedisore, sociale, të shëndetit dhe sigurisë. Menaxheri SHSM duhet të ketë njohuri mbi kërkesat e performancës të BERZH-it dhe legjislacionit shqiptar të M&S. Ai/ajo duhet t'i raportojë drejtpërdrejti Drejtorit të Projektit EPC.					
1.5	**EPC-PMMS:** Të kërkohet në mënyrë ligjërisht të detyrueshme përgatitja nga Kontraktori EPC, i një Plani të Menaxhimit të M&S ("EPC-PMMS"), i projektuar për të përmbushur Politikën e M&S të KESH-it, legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e performancës të BERZH-it 2019. KESH duhet të shqyrtojë, miratojë dhe monitorojë zbatimin efektiv të EPC-PMMS. Kontraktori EPC duhet të kalojë detyrimin për të përmbushur EPC-PMMS të miratuar në zinxhirin e tij të nënkontraktorëve, në një mënyrë ligjërisht të detyrueshme. EPC-PMMS duhet të përfshijë planet ose procedurat që kërkohen shprehimisht në këtë PVMS, një procedurë ndryshimi të projektimit dhe një procedurë të menaxhimit të papajtueshmërisë.	Pajtueshmëria me kërkesat e zbatueshme	Legjislacioni kombëtar BERZH KP1	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën EPC nga KESH-i 2. PMMS duhet të përgatitet, zbatohet dhe të vijojë në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja	1. Në fazën e tenderit 2. EPC-PMMS duhet të përgatitet dhe miratohet nga KESH përpara fillimit të punës nga Kontraktori EPC	1. Kërkesat përfshihen në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. EPC-PMMS përgatitet nga kontraktorët, miratohet dhe monitorohet nga KESH
1.6	**Raportimi M&S**: Me përdorimin e një modeli të rënë dakord me BERZH-in, të raportohet pranë BERZH-it mbi (i) Statusin e	Monitorimi	BERZH KP1	Mbajtësi i PVMS-së së KESH, bazuar në modelin e dhënë në PMMS	Çdo tre muaj gjatë ndërtimit Çdo vit pas ndërtimit, deri në përfundim të marrëveshjes së	Raportet i dorëzohen BERZH-it dhe miratohen

	zbatimit të PVMS-së dhe (ii) performancën mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të projektit, dhe (iii) menaxhimin e papajtueshmërive dhe veprimet korrigjuese.				financimit	
KP2	**Puna dhe Kushtet e Punës**					
2.1	Të zhvillohet një proces për menaxhimin e rreziqeve të punës së detyruar në zinxhirët e furnizimit me energji diellore në përputhje me çdo politikë ose udhëzim të miratuar herë pas here nga BERZH-i. Kjo do të përfshijë, por jo domosdoshmërisht kufizohet në: ○ Politikën e burimit përgjegjës për klientin ose kodin e sjelljes së furnizuesit ose ekuivalentin ○ Të sigurohet që dokumentacioni i prokurimit të përfshijë kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të punës së detyruar dhe paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur për të mbështetur vlerësimin e furnitorëve të propozuar dhe ndërmarrjen e vlerësimit të rrezikut të zinxhirit të furnizimit ○ Të përgatitet zinxhiri i furnizimit në formën e një Preventivi specifik të projektit të siguruar nga secili Ofertues dhe	Rreziqet e punës së detyruar / të fëmijëve	Praktikat e mira ndërkombëtare BERZH KP2 KFN SP2 Udhëzues i BE-së për kujdesin e duhur për bizneset e BE-së për trajtimin e rrezikut të punës së detyruar në operacionet e tyre dhe zinxhirët e furnizimit	Niveli Drejtues i shoqërisë me mbështetjen e Konsulentit të NJZP-së dhe Konsulentit të Mbikëqyrjes	1. Para fillimit të procesit të prokurimit 2. Para përfundimit të prokurimit dhe dhënies së kontratës 3. Gjatë prodhimit dhe para transportit 4. Sipas nevojës	1. Dokumentacioni i prokurimit përfshin kërkesat përkatëse 2. Kryhet vlerësimi i rrezikut të zinxhirit të furnizimit dhe dokumentacioni i kërkuar vihet në funksionim 3. Verifikimi i zinxhirit të furnizimit 4. Menaxhimi i ndryshimeve

	duke ndërmarrë një verifikim të rrezikut të zinxhirit të furnizimit të furnizuesve dhe nënfurnizuesve të propozuar të komponentëve diellor në një nivel të rënë dakord me BERZH-in o Vetëdeklarimet nga ofertuesit dhe prodhuesit e moduleve diellore në lidhje me rreziqet e punës dhe pajtueshmërinë me Konventat dhe Protokollet Themelore të ONP-së. o Dokumenti i Ofertuesit dhe prodhuesit të modulit diellor ose kodi i sjelljes që mbulon operacionet e prodhuesve të paneleve dhe furnizuesve të komponentëve diellorë, ku specifikohet qartë se puna e detyruar është e ndaluar dhe se furnizuesit e komponentëve diellorë duhet të zbatojnë të njëjtat ndalime për furnizuesit e tyre të komponentëve diellorë. o Aftësia për të kërkuar auditime të fundit të punës nga prodhuesit e propozuar të moduleve diellore në përputhje me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe parimet e auditimit; auditime të tilla do të kërkohen në bazë të rezultateve të shqyrtimit të rrezikut dhe siç					

	është rënë dakord me BERZH-in ○ Aftësia për të kërkuar zëvendësimin e prodhuesve ose nënfurnizuesve diellorë kur auditime të tilla nuk do të kryhen në të ardhmen ○ Masat për verifikimin e furnizuesit të zinxhirit të furnizimit gjatë prodhimit të komponentëve ○ Një proces për menaxhimin e ndryshimeve të propozuara në zinxhirin e furnizimit me energji diellore dhe dorëzimin e dokumentacionit të përditësuar BERZH-it					
2.2	**Punësimi formal:** EPC duhet të sigurojë që personeli i tij dhe i gjithë personeli i punësuar në kantierin e ndërtimit përmes zinxhirit të tij të nënkontraktorëve, të punësohet dhe deklarohet zyrtarisht, siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar. Kontraktori EPC duhet të ndërmarrë gjatë ndërtimit auditime të rastësishme mujore në të gjithë zinxhirin e tij të nënkontraktorëve, për të verifikuar pajtueshmërinë e kushteve të punësimit me dispozitat e kodit shqiptar të punës, BERZH KP2	Kodi i Punës	BERZH KP2 Legjislacioni kombëtar	Menaxheri MSHS i KESH-it për organizimin e auditimeve EPC duhet të zbatojë kërkesën dhe ta kalojë atë në zinxhirin e saj të nënkontraktorëve	Gjatë ndërtimit	BNJ kryejnë auditimet dhe inspektimet. Papajtueshmëritë njoftohen dhe adresohen. Objektivi i EPC-së: zero punësim informal në Projekt

	dhe PVMS-së aktuale. Rezultatet e këtyre auditimeve duhet të jepen në raportet mujore të M&S KESH-it.					
2.3	**Puna e fëmijëve:** Të përfshihet në kontratën EPC ndalimi i punësimit të punëtorëve nën 18 vjeç për ndërtimin e impiantit FV. Ndalimi duhet të vijojë në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja në një mënyrë ligjërisht të detyrueshme.	Rreziku i punës së fëmijëve	BERZH KP2	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet dhe të kalojë në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit& funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. Kërkesa zbatohet dhe kalon në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja
2.4	**Punëtorët jo të punësuar:** Për të gjithë periudhën e funksionimit, të kërkohet në mënyrë ligjërisht të detyrueshme se ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët të sigurojnë që personeli që punon në impiantin FV, të jetë zyrtarisht i punësuar dhe deklaruar, si dhe i sigurohen kushtet e punës siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar dhe BERZH KP2.	Rreziku i kushteve të punësimit poshtë standardeve për punëtorët jo-punonjës	BERZH KP2 Legjislacioni Kombëtar	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit të ofruesve të shërbimeve dhe kontraktorëve dhe në kontratë nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit dhe funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. Kërkesa zbatohet nga ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët
2.5	**Shmangia e ambientit të izoluar të punës:** Kantieri i FV-së duhet të funksionojë në mënyrë që stafi dhe punëtorët të mos punojnë kurrë vetëm në ambiente të izoluara – kjo vlen veçanërisht për punëtorët e punësuar për mirëmbajtjen e kantierit FV (mirëmbajtje teknike, pastrim i bimësisë…) dhe për rojet e sigurisë.	Rrezik aksidenti për punëtorët e izoluar	BERZH KP2 Praktikë e mirë ndërkombëtare	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit të ofruesve të shërbimeve dhe kontraktorëve dhe në kontratë nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit dhe funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. Kërkesa zbatohet nga ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët

2.6	**Akomodimi i punëtorëve:** Të përfshihet në kontratën EPC detyrimi për të siguruar personelin që nuk mund të kthehet në shtëpi gjatë natës me akomodime që përputhen me udhëzuesin e BERZH/KFN për akomodimin e punëtorëve. Ky detyrim duhet të kalojë në zinxhirin e nënkontraktorëve të Kontraktorit dhe në auditimet mujore të burimeve njerëzore gjatë ndërtimit duhet të përfshihet inspektimi i akomodimit të punëtorëve. Kontraktori EPC duhet gjithashtu të projektojë dhe ndërtojë objektet e kantierit të FV-së, në mënyrë që gjatë operimit rojet ose stafi tjetër në turne të kenë akses në një akomodim në kantier që është në përputhje me udhëzuesin e BERZH/KFN për strehimin e punëtorëve, veçanërisht në lidhje me objektet sipas gjinisë, ujin e pijshëm, tualetet, gropën septike, ngrohjen/ajrin e kondicionuar.	Akomodimi i punëtorëve	BERZH KP2 Praktikë e mirë ndërkombëtare	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet dhe vijojë në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. Kërkesa zbatohet dhe kalon në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja
2.7	**Kodi i Sjelljes:** EPC-së t'i kërkohet të përgatisë, t'i dorëzojë miratimin KESH-it dhe t'u sigurojë punonjësve një Kod Sjelljeje që përshkruan detyrimet e sjelljes për punonjësit. Kodi i Sjelljes duhet t'i komunikohet me shkrim dhe përmes një udhëzimi të gjithë stafit që punon në projekt, qoftë i rekrutuar drejtpërdrejt nga kontraktorët dhe ofruesit e shërbimeve ose nga nënkontraktorët e	Shmangia e GBVH (*dhuna dhe ngacmimi seksual me bazë gjinore*)	BERZH KP2 Praktikë e mirë ndërkombëtare	1.Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet dhe vijojë në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratat. 2. Kërkesa zbatohet dhe kalon në zinxhirin e nënkontraktorëve nga EPC-ja

	tyre. Kodi i Sjelljes duhet të trajtojë minimalisht (i) marrëdhëniet respektuese me komunitetet lokale, (ii) ndalimin e çdo forme të ngacmimit ose dhunës me bazë gjinore ndaj punonjëseve femra ose fshatarëve, (iii) ndalimin e drogës dhe alkoolit.					
2.8	Të zhvillohen partneritete me ofruesit e arsimit për të promovuar karrierat STEM për gratë e reja përmes panaireve të punës të fokusuara tek gratë, leksioneve/mentorimit nga modelet e roleve femra etj.	Tërheqja e talenteve	Praktika më e mirë Strategjia e BERZH-it për promovimin e barazisë gjinore	Burimet e veta	4 vjet pas nënshkrimit të huasë	Zhvillohen ose jepet kontribut për 2 + aktivitete të orientimit në karrierë.
KP3	**Efikasiteti i burimeve dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes**					
3.1	**Pastrimi i paneleve diellore:** Të projektohet dhe ndërtohet impianti FV për pastrimin kimik, ose të ofrohet për moskundërshtim nga ana e BERZH-it një strategji e burimit të ujit që synon të shmangë konfliktet e përdorimit të ujit edhe në vitet jashtëzakonisht të thata.	Menaxhimi i mbetjeve	Legjislacioni kombëtar BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
3.2	**Menaxhimi i mbetjeve që rezultojnë nga ndërtimi/ndotja:** Kontraktori EPC të përfshijë në EPC-PMMS një plan të menaxhimit të mbetjeve. Planet e menaxhimit të mbetjeve duhet të trajtojnë minimizimin dhe klasifikimin, grumbullimin dhe riciklimin ose	Menaxhimi i mbetjeve	Legjislacioni kombëtar BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC

	asgjësimin e mbetjeve, duke përfshirë një verifikim të kapacitetit dhe ligjshmërisë së mjaftueshme të shoqërive të përzgjedhura të depozitimit/riciklimit.					
3.3	**Riciklimi i paneleve diellore:** Projekti të pajiset me pajisje elektrike dhe elektronike që plotësojnë kërkesat e Direktivës 2011/65/BE, në mënyrë që të mund të riciklohen më vonë në një mënyrë që të përmbushen objektivat e Direktivës. Të kërkohet nga furnizuesit e paneleve FV që të përmbushin objektivat kryesore të Direktivës MPEE për sa i përket grumbullimit, trajtimit, rikuperimit dhe asgjësimit të qëndrueshëm mjedisor të MPEE-së: • Panelet që dorëzohen të thyera gjatë periudhës së ndërtimit, duhet të hidhen në një objekt me kapacitet teknik për të rikikluar komponentët e tyre, me shpenzimet e furnizuesit. Furnizuesi duhet të sigurojë një dëshmi të dorëzimit të paneleve të thyera në një objekt të tillë. • Panelet që janë thyer ose jashtë funksionit gjatë ndërtimit ose funksionimit, duhet të asgjësohen sipas direktivës MPEE me shpenzimet e furnizuesit.	Riciklimi i paneleve	BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC

3.4	**Menaxhimi i bimësisë (ndërtimi):** Gjatë studimeve të hollësishme, të vlerësohet vëllimi i biomasës (pemë, shkurre) që do të pritet dhe të përcaktohet një strategji e mbetjeve të biomasës për ndërtim, duke marrë parasysh një nga zgjidhjet e mëposhtme, sipas prioritetit: (i) mbulimi i mbetjeve të biomasës për ripërdorim nga projekti, për shembull kur rehabilitohen zona të përkohshme, ose (ii) ripërdorimi nga një palë e jashtme e autorizuar. (p.sh. input për impiantin e biomasës ose impiantin e mekanizmit, impiantin përpunues), ose (iii) asgjësimi në një vend të autorizuar. Ndalohet djegia e biomasës. Për periudhën e funksionimit, të përcaktohet dhe zbatohet një strategji e menaxhimit të bimësisë, duke marrë parasysh ndjeshmëritë ndaj biodiversitetit (sezoni i foleve të zogjve, bimët e mbrojtura…)	Menaxhimi i mbetjeve të biomasës	BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
3.5	**Burimi i materialit dhe ujit:** Gjatë ndërtimit, të sigurohet materiali (rërë, zhavorr…) dhe uji i nevojshëm për Projektin vetëm nga furnizues të autorizuar ligjërisht. Gjatë operimit, nëse vendoset të përdoret uji për pastrimin e paneleve, të sigurohet nga një burim i autorizuar, në një periudhë të vitit dhe në vendin ku përdorimi i ujit për pastrimin e paneleve diellore nuk sjell konflikt të përdorimit të ujit	Efikasiteti i burimeve	BERZH KP3 Legjislacioni kombëtar	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët EPC gjatë ndërtimit 3. Kërkesa duhet të zbatohet nga kontraktorët e KESH-it gjatë operimit	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit 3. Gjatë funksionimit	1. Kërkesat përfshihen në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Kërkesa zbatohet nga KESH-i

	me ujin e pijshëm ose shërbimet e ujitjes bujqësore.					
3.6	**Kontrolli i erozionit:** Të monitorohet erozioni në të gjithë kantierin FV dy herë në vit (pas dimrit dhe pas verës). Të identifikohen vendet ku shfaqet toka e zhveshur dhe nëse rezulton se erozioni ndodh dhe përparon, të kryhen veprime korrigjuese lokale për të ndaluar erozionin dhe ë përforcuar ri-rritje të bimësisë. Të vijojë monitorimi deri në 1 vit pas konstatimit se vendi FV është rikolonizuar plotësisht nga bimësia.	Parandalimi dhe kontrolli i erozionit	BERZH KP3	Menaxheri M&S i KESH-it	Gjatë funksionimit	Nuk ka erozion të pakontrolluar në vendin e FV-së.
3.7	**Derdhjet e naftës:** Kontraktori EPC duhet të përfshijë në EPC-PMMS një procedurë/plan për parandalimin dhe menaxhimin e derdhjes së naftës.	Parandalimi i ndotjes	BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
3.8	**Ndalimi i herbicideve:** Të ndalohet përdorimi i herbicideve për kontrollin e bimësisë gjatë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit.	Kontrolli i ndotjes	BERZH KP3	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktorët EPC gjatë ndërtimit 3. Kërkesa duhet të zbatohet nga kontraktorët e KESH-it gjatë operimit	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit 3. Gjatë funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Kërkesa zbatohet nga KESH-i

KP4	Shëndeti dhe Siguria					
4.1	**SHSP Menaxhimi / Ndërtimi**: Kontraktori EPC të përfshijë në EPC-PMMS një plan të detajuar të menaxhimit të SHSP-së që mbulon aktivitetet e tij dhe trajton të paktën (por pa u kufizuar në): (i) organizimin dhe trajnimin e punonjësve të SHSP-së, (ii) pajisjet mbrojtëse personale dhe kolektive, (iii) punët që kërkojnë leje, autorizim ose miratim paraprak, (iv) rregullimin e lëvizjes në punë, makinat e rënda. (vi) kufizimet e aktiviteteve në natyrë në kushte me mot të rrezikshëm, (vii) sigurinë e sistemeve elektrike të ndezura, (viii) ndihmën e parë dhe reagimin në rast situatash emergjente, (ix) monitorimin e SHSP-së, (x) menaxhimin e mospërputhjeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Plani do të përgatitet 2 muaj përpara fillimit të ndërtimit nga kontraktori EPC dhe do t'i nënshtrohet miratimit të KESH-it para fillimit të punimeve.	Menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë	BERZH KP4 Legjislacioni kombëtar	Kontraktorët, me kërkesë të KESH-it	1. Para periudhës së ndërtimit 2. Gjatë periudhës së ndërtimit	1. Plani i Menaxhimit të SHSP-së përgatitet nga Kontraktori EPC dhe miratohet nga KESH-i. 2. Plani i Menaxhimit të SHSP-së zbatohet nga Kontraktori EPC.
4.2	**SHSP Menaxhimi / Funksionimi** Kontraktori EPC të përgatisë dhe KESH të zbatojë një plan të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë që plotëson legjislacionin shqiptar dhe kërkesat KP4 për periudhën e funksionimit. Plani do të përgatitet nga Kontraktori EPC përpara fillimit të operimit dhe	Menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë	BERZH KP4 Legjislacioni kombëtar	Kontraktorët, me kërkesë të KESH-it	1. Para periudhës së funksionimit 2. Gjatë periudhës së funksionimit	1. Plani i Menaxhimit të SHSP-së përgatitet nga Kontraktori EPC dhe miratohet nga KESH-i. 2. Plani i Menaxhimit të SHSP-së zbatohet nga KESH-i.

	do t'i nënshtrohet miratimit të KESH-it.					
4.3	**Ekspozimi ndaj gjuetarëve:** Të mbahen kontakte me gjuetarët vendas që të informohen për praninë e punëtorëve përpara dhe pas ndërtimit të impiantit FV. Të kërkohet që i gjithë personeli që punon gjatë rilevimit para ndërtimit, të veshin xhaketa me vizibilitet të lartë. Të kërkohet nga EPC të zbusë rreziqet që lidhen me gjuetinë në vendet përreth, (i) gjatë para-ndërtimit dhe ndërtimit, duke veshur gjatë gjithë kohës xhaketa me vizibilitet të lartë për çdo person që punon brenda ose rreth impiantit FV, (ii) ndalimin e çdo aktiviteti dhe grumbullimin në një pikë të sigurt në rast të të shtënave aty pranë, (iii) gjatë kohëzgjatjes së projektit, monitorimin e incidenteve/aksidenteve të gjuetisë dhe raportimin e tyre KESH-it për angazhim të mëtejshëm me shoqatat/përfaqësuesit lokalë të gjuetarëve për të përmirësuar vazhdimisht sigurinë e punëtorëve dhe infrastrukturën.	Siguria e punëtorëve	BERZH KP4 Legjislacioni kombëtar	Menaxheri M&S i KESH-it	Para dhe gjatë ndërtimit	Nuk duhet të kryhet asnjë aktivitet i pakontrolluar gjuetie që kërcënon sigurinë e punëtorëve
4.4	**Trajnimi i punëtorëve / udhëzimi i vizitorëve**: Kontraktori EPC dhe KESH të përgatisin dhe zbatojnë për të gjithë punëtorët e përfshirë në projekt, një	Menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë	BERZH KP4 Legjislacioni	1. Kontraktori EPC gjatë ndërtimit 2. Menaxheri M&S i KESH-it	1. Gjatë periudhës së ndërtimit 2. Gjatë periudhës së funksionimit	1. Kryhen trajnime/udhëzime, të mundësohet një dokument. 2. Kryhen trajnime/udhëzime, të mundësohet një dokument.

	trajnim mbi SHSP-në përpara fillimit të çdo aktiviteti dhe të mbajnë një regjistër të trajnimeve të tilla. Vizitorët në kantierin e ndërtimit të pajisen me një udhëzim që mbulon rreziqet kryesore të SHSP-së dhe të mbahet një regjistër i udhëzimeve të tilla.		kombëtar			
4.5	**Menaxhimi i rreziqeve të trafikut në komunitet**: Kontraktori EPC të përfshijë në EPC-PMMS një Plan të Menaxhimit të Rreziqeve të Trafikut, duke përfshirë (i) sinjalistikën e kantiereve të ndërtimit, (ii) vende të organizuara për punëtorët që të parkojnë automjetet dhe për kamionët e furnizimit që presin, (iii) minimizimin e ndërprerjeve për trafikun lokal, (iv) monitorimin e incidenteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm.	Siguria e komunitetit	BERZH KP4 Legjislacioni kombëtar	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
4.6	**Rojet e sigurisë**: Rojet e sigurisë duhet të marrin të njëjtat trajnime si i gjithë personeli tjetër i Ofruesve të Shërbimeve. Gjithashtu, ata duhet të marrin një trajnim specifik të fokusuar në ndërgjegjësimin e situatës (identifikimi i hershëm i shenjave paralajmëruese të një situate të mundshme të dhunshme) dhe de-përshkallëzimi i dhunës.	Rojet e sigurisë	BERZH KP2 dhe KP4	Menaxheri M&S i KESH-it, në koordinim me punëdhënësit e rojeve të sigurisë	Para dhe gjatë ndërtimit / funksionimit	Trajnohen rojet e sigurisë

KP5	**Marrja e tokës, risistemimi i pavullnetshëm dhe zhvendosja ekonomike**					
5.1	**Plani i Risistemimit** Të kërkohet nga ekipet e projektimit të projektojnë vendndodhjen e FV-së dhe itinerarin TL në një mënyrë që minimizon ndikimet, sipas PVMS-së aktuale dhe Kornizës së Risistemimit (KR). Të mobilizohet një ekip i risistemimit, sipas KR-së, për ta zhvilluar KR-në në një plan dhe për ta zbatuar atë. Të lëshohet një raport i ekzekutimit të marrjes së tokës dhe risistemimit që tregon zbatimin e PR-së	Risistemimi ekonomik	BERZH KP5 Legjislacioni Kombëtar	Menaxheri M&S i KESH-it, në koordinim me ekipet teknike	Para ndërtimit Pas përfundimit të zbatimit të PR-së	Përgatitet plani i risistemimit, merret toka dhe paguhen kompensimet në përputhje me KP5 dhe legjislacionin kombëtar Raporti i ekzekutimit i jepet BERZH-it
KP6	**Biodiversiteti dhe burimet e gjalla natyrore**					
6.1	**Ruajtja e mbrojtjeve të vendndodhjes së FV-së:** Të përfshihet në specifikimet për projektimin e impiantit FV detyrimi për të ruajtur mbrojtjet më të larta se 2 m nga punimet tokësore dhe heqja e bimësisë. Gurët në këto gardhe nuk duhet të hiqen/zhvendosen. Pemët dhe shkurret mund të priten në një lartësi prej 2 m (për të shmangur hijen e paneleve diellore), por nuk duhet të eliminohen. Prerja e pemëve dhe	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH-i 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Menaxheri M&S i KESH-it me mbështetjen e një topografi në kantier.	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit 3. Gjatë ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC. Habitatet që do të ruhen, përcaktohen në kantier përpara ndërtimit, me miratimin e menaxherit M&S të KESH-it. 3. Ruajtja e gardheve, gurëve dhe bimësisë monitorohet dhe dokumentohet. Raportohet pranë BERZH-it përmes raporteve tremujore. BEZH-it i

	shkurreve nuk duhet të kryhet gjatë muajve prill-qershor, për të lejuar një sezon të suksesshëm mbarështimi për zogjtë dhe kafshët e tjera.					jepet raporti përfundimtar që dokumenton zbatimin efektiv të veprimit.
6.2	**Ruajtja e tokës së kultivuar, pemëve dhe pyjeve:** Të përfshihet në specifikimet për projektimin e nënstacionit FV dhe të rrugëve të linjës së transmetimit detyrimi për të shmangur çdo ndikim në tokën e kultivuar, pemët dhe pyjet që do të ruhen (siç identifikohet në fotot bashkëlidhur në fund të kësaj tabele). Në kantierin e nënstacionit të shënohen qartë me shenja parcelat që duhen ruajtur.	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
6.3	**Flora që përbën interes për tu ruajtur**: Të kryhen studime në terren në kantierin e FV-së në fund të shtatorit-fillimit të tetorit, për të kontrolluar praninë e *C. hadriaticus* dhe për të identifikuar praninë e *C. autumnale*. Të mblidhen ekzemplarët e identifikuar (me zhardhok) për zhvendosje, nën kontrollin e një botanisti me përvojë. E njëjta procedurë të përsëritet për të njëjtën punë në fund të prillit për *Anacamptis pyramidalis* dhe *Orchis sp*., *Ophrys sp*	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	Menaxher M&S i KESH-it, me mbështetjen e një botanisti me përvojë dhe të njohur	Para ndërtimit	Nuk ka humbje të *C. hadriaticus, C. autumnale, Anacamptis pyramidalis* dhe *Orchis sp. ose Ophrys sp.*

	të tjera.					
6.4	**Kontrolli i specieve invazive**: Monitorimi dhe kontrolli i specieve invazive të florës duhet të kryhet brenda kantierit të FV/nënstacionit dhe në bazën e shtyllave të Linjës së Transmetimit në fillim të verës, kur shumica e specieve invazive shumëvjeçare kanë arritur një madhësi ku mund të identifikohen lehtësisht, por nuk kanë filluar të prodhojnë fara. Të gjithë ekzemplarët e identifikuar duhet të eliminohen.	Menaxhimi i specieve invazive	BERZH KP6	Menaxheri M&S i KESH-it, me mbështetjen e një botanisti me përvojë dhe të njohur	Pas ndërtimit, gjatë dy viteve të para të funksionimit	Speciet invazive të eliminohen
6.5	**Periudha e folezimit të shpendëve sensitivë**: Të shmanget fillimi i punimeve të ndërtimit gjatë sezonit të folezimit (prill – qershor).	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
6.6	**Minimizimi i rrezikut të përplasjes së shpendëve:** Të instalohen devijuesit metalikë 3D të shpendëve nga nënstacioni Kajan në kantierin e FV-së në telin e tokëzimit të linjës së transmetimit.	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
6.7	**Menaxhimi i foleve të shpendëve:** Të angazhohet një ornitolog shqiptar me përvojë për të ndërmarrë studime të foleve të shpendëve brenda	Mbrojtja e llojeve të biodiversitetit me interes për ruajtje	BERZH KP6	Menaxheri M&S i KESH-it, me mbështetjen e një botanisti me përvojë dhe të njohur	Pas ndërtimit, gjatë dy viteve të para të funksionimit	Përgatitet dhe zbatohet strategjia e menaxhimit të foleve të shpendëve

	kantierit të FV-së gjatë dy viteve të para të funksionimit (në maj) dhe të përgatitet një procedurë e menaxhimit të foleve të shpendëve që do të zbatohet nga stafi operativ.					
6.8	**Monitorimi dhe hulumtimi i molusqeve**: Në bashkëpunim me një malakolog të njohur dhe një universitet, të kryhet përmes një teze doktorature monitorimi i të gjithë molusqeve tokësore në zonën e Projektit para dhe pas ndërtimit, për të dokumentuar ndikimin e skemës FV.	Mbrojtja e llojeve të biodiversitetit me interes ruajtjeje	BERZH KP6	Menaxheri M&S i KESH, me mbështetjen e një malakologu me përvojë dhe të njohur	Para dhe gjatë ndërtimit, dhe 5 vitet e para të funksionimit	Raportet disponohen publikisht dhe lirisht në dispozicion në shqip dhe anglisht, duke dokumentuar ndikimin e impiantit FV në molusqet tokësore.
6.9	**Ruajtja e herpetofaunës:** Të kontraktohet një herpetolog me përvojë për të organizuar dhe zbatuar grumbullimin dhe zhvendosjen në habitate të përshtatshme të herpetofaunës së pranishme në kantierin e FV-së. Ky veprim duhet të planifikohet paraprakisht, pasi grumbullimi duhet të ndërmerret përpara fillimit të punimeve por në çdo rast gjatë sezonit kur herpetofauna është aktive: Periudha e përshtatshme për grumbullimin/zhvendosjen e herpetofaunës është korrik-tetor. Kjo është pas sezonit të riprodhimit (në mes të periudhës mars - qershor) dhe menjëherë para letargjisë (nëntor - mesi i muajit mars).	Mbrojtja e llojeve të biodiversitetit me interes ruajtjeje	BERZH KP6	Menaxheri M&S i KESH, me mbështetjen e një herpetologu me përvojë dhe të njohur	Sezonin e kaluar korrik-tetor para fillimit të ndërtimit	Herpetofauna mblidhet dhe zhvendoset nga një herpetolog me përvojë

6.10	**Ndërgjegjësimi i punëtorëve**: Për periudhën e ndërtimit, kërkohet që EPC-ja të përfshijë në kodin e sjelljes së punëtorëve rritjen e ndërgjegjësimit për praninë e faunës me interes për ruajtje (zogj, gjitarë, herpetofauna, molusqe) në zonën e Projektit. Kontraktorët, nënkontraktorët dhe personeli i tyre duhet të informohen se punonjësit që do të vrasin ose mbledhin me dashje kafshë nga kantieri i ndërtimit, do të përjashtohen nga projekti pa njoftim paraprak. Anasjelltas, punëtorët duhet të nxiten që të raportojnë ekzemplarin tek personeli i SHSM-së në kantier. Personeli i SHSM-së duhet të trajnohet për të kapur dhe menaxhuar në mënyrë të sigurt ekzemplarin që do të konstatohet gjatë ndërtimit. Për periudhën e funksionimit, të trajnohen punëtorët (veçanërisht ata të përfshirë në menaxhimin e bimësisë) që të jenë të vëmendshëm ndaj faunës që do të zhvillohet brenda kantierit të FV-së.	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Kërkesa duhet të zbatohet nga KESH	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit 3. Gjatë funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC, disponohet regjistri i trajnimit. 3. Trajnimi zbatohet nga KESH-i, disponohet regjistri i trajnimit.
6.11	**Vijimësia ekologjike**: Të kërkohet që EPC-ja të krijojë në fund të periudhës së vendosjes në punë, pasi punëtorët të çmobilizohen, kalime 30x30 cm çdo 20 m në gardhin rreth kantierit të FV-së. Gjatë funksionimit, në këto vende nuk duhet të ketë pengesa. Të organizohen vizita vjetore monitoruese të kantierit të FV-së me herpetologun për të paktën 5 vjet për të vlerësuar rikolonizimin e	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Mirëmbajtje nga KESH	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë ndërtimit 3. Gjatë funksionimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC 3. Të mos ketë pengesa në kalime

	kantierit të FV-së nga breshkat.					
6.12	**Shmangia e ndotjes nga drita:** Të kërkohet nga EPC-ja që kjo e fundit të projektojë dhe ndërtojë impiantet FV, në mënyrë që të shmanget ndriçimi i përhershëm i kantierit të FV-së gjatë ndërtimit ose funksionimit, në mënyrë që të shmanget shqetësimi i habitatit gjatë natës. Aty ku nevojitet drita e natës për arsye sigurie/mbrojtjeje, të përdoren drita me intensitet të ulët të drejtuara në tokë, të kontrolluara nga detektorët e pranisë dhe një çelës automatik.	Mbrojtja e biodiversitetit	BERZH KP6	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit, prokurimit dhe ndërtimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
6.13	**Menaxhimi i bimësisë/ foleve (funksionimi):** Të kontraktohet një botanist dhe ornitolog me përvojë për të përgatitur, zbatuar dhe monitoruar një "plan të menaxhimit dhe monitorimit të bimësisë/folesë". Plani duhet të përgatitet në bazë të një vizite të plotë në kantier. Plani duhet të përfshijë rekomandime për (i) menaxhimin e duhur të bimësisë, për të minimizuar rreziqet për zogjtë që folezojnë në tokë dhe speciet e florës me interes për ruajtje, dhe (ii) udhëzimin dhe trajnimin e personelit që punon përkatësisht herë pas here ose përgjithmonë në kantier në lidhje me menaxhimin e foleve.	Mbrojtja e llojeve të biodiversitetit me interes ruajtjeje	BERZH KP6	Menaxher M&S i KESH, me mbështetjen e një botanisti dhe ornitologu me përvojë dhe të njohur	1. Viti i parë i funksionimit 2. Gjatë funksionimit	1. Përgatitet plani i menaxhimit dhe monitorimit të bimësisë/folesë 2. Plani zbatohet


PR8	Trashëgimia Kulturore					
8.1	**Gjetje të rastësishme:** Të përgatitet një procedurë për gjetjen e rastit për projektin në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BERZH KP8, dhe të kërkohet që të përfshihet kontraktualisht në EPC-PMMS. Të kërkohet nga kontraktori EPC që të trajnojë punëtorët për natyrën e gjetjeve të mundshme të rastësishme dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.	Gjetje të rastësishme	BERZH KP8	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC
8.2	**Studim arkeologjik:** Të kryhet një studim arkeologjik para ndërtimit të zonës së impiantit FV 50 MW, duke përfshirë të paktën punimet në kantier për një javë. Studimi duhet të kryhet nga Arkeologë të Licencuar, duke iu referuar neneve 134, 139, 140 të Ligjit nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeumet". Arkeologët duhet të dorëzojnë dokumentet e kërkuara me ligj, në mënyrë që të lejohet ndërtimi i Projektit.	Kërkimi i gurëve të prerë	BERZH KP8 Legjislacioni Kombëtar	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC duke përdorur një arkeolog me përvojë dhe të licencuar	1. Në fazën e ofertimit 1. Para ndërtimit	Nuk ka humbje të informacionit arkeologjik
8.3	**TL / shmangia e varrezave:** Pasi të jetë gati rruga konceptuale e TL-së, të verifikohet përshtatshmëria e gjurmës së parashikuar ndaj varrezave përmes një shëtitjeje përgjatë gjithë gjurmës së TL-së.	Shmangia e varrezave	BERZH KP8	1. Kërkesa duhet të përfshihet në dokumentet e tenderit dhe kontratën e Kontraktorit EPC nga KESH 2. Kërkesa duhet të zbatohet nga Kontraktori EPC	1. Në fazën e tenderit 2. Gjatë projektimit dhe prokurimit	1. Kërkesa përfshihet në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. 2. Kërkesa zbatohet nga Kontraktori EPC

PR10	Zbulimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit					
10.2	**Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit / mekanizmi i ankesave** Të zbatohet Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (duke përfshirë Mekanizmin e Ankesave) për Projektin. Plani të rishikohet dhe përditësohet çdo vit.	Informimi i palëve të interesit dhe ndërgjegjësimi	BERZH KP10	Menaxheri MSHSS i KESH-it	Sipas planit SEP	Zbatohet SEP dhe Mekanizmi i Ankesave Regjistri mundësohet menjëherë sapo të kërkohet nga BERZH-i.

Figura 1 – Toka e kultivuar dhe pyjet që do të ruhen në parcelën e tokës së nënstacionit (ngjyrë rozë: të korrat – ngjyrë jeshile: pyje – ngjyrë e verdhë: ullinj)



Figura 2 - Pylli që duhet shmangur nga rruga e linjës së transmetimit (këndi i sipërm djathtas)



SKEDULI 3 – STANDARDET E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI DIELLORE

1. PËRKUFIZIMET

Termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

Kërkesat e performancës të BERZH-it të lidhura me punën e detyruar nënkupton kërkesat e parashikuara në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it të prillit 2019 dhe kërkesat e përcaktuara të performancës dhe që lidhen me, dhe në veçanti paragrafin 2.4 të Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, Kërkesën e Performancës 1 dhe Kërkesën e Performancës 2 (*Puna dhe Kushtet e Punës*).

Punë e detyruar nënkupton të gjithë punën ose shërbimin e kryer në mënyrë jo-vullnetare, e cila i kërkohet një individi nën kanosjen e forcës ose dënimit, siç përcaktohet më tej nga Instrumentet e ONP-së mbi Punën e Detyruar.

Kërkesa për punë të detyruar nënkupton çdo pretendim, procedim, njoftim zyrtar ose hetim nga një person në lidhje me një ligj të lidhur me punën e detyruar.

Çështja e punës së detyruar është çdo çështje, =objekt i ndonjë kërkese për punë të detyruar dhe kërkesave për punë të detyruar.

Ligjet që lidhen me punën e detyruar nënkupton çdo ligj, rregull ose rregullore të zbatueshme (duke përfshirë detyrimet e traktateve ndërkombëtare) që lidhet me punën e detyruar, duke përfshirë Instrumentet e ONP-së për punën e detyruar.

Dispozitat që lidhen me punën e detyruar nënkupton dispozitat e përcaktuara në Aneksin A dhe Aneksin B të Skedulit 4 (*Dispozitat e Punës së Detyruar*).

